



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 319 Prot.

Tiranë, më dt. 31.05.2018

VENDIM

Nr.284, dt. 31.05.2018

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 31.05.2018, pasi shqyrtoi termat dhe detyrën e projektimit të diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: "Rikualifikimi në zonën e mbrojtur urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë: Projekti Arkitektonik A.O.4, A.O.12/13/14; B.O.1, B.O.12, B.O.14, B.O.29, B.O.30, B.O.34, B.O.32, B.O.10, B.O.13", Vlorë, me subjekt aplikues AADF.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas pikës 5, neni 17, të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Mirela Kumburo Furxhi



SEKRETAR I KKR

Arta Dallani